

**për vaksinimin kundër tetanosit, difterisë, pertusis (kolla e mirë), virusit haemophilus influenzae b (Hib), poliomielitit dhe hepatitit B**

Në përgjithësi për foshnjat dhe fëmijët e vegjël rekomandohet vaksinimi kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve nga virusi Hib, kundër poliomielitit dhe hepatitit B. Edhe alternativat moderne të trajtimit nuk mund të parandalojnë gjithmonë zhvillimet dhe pasojat serioze nga këto sëmundje infektive tek të pavaksinuarit. Nga këto sëmundje mbron vetëm vaksinimi i kryer në momentin e duhur.

Është e logjikshme që për t'u mbrojtur nga këto 6 sëmundje duhet bërë vaksinimi me një vaksinë polivalente. Me anë të kësaj ulet numri i injektiveve të nevojshme për mbrojtjen nga sëmundjet, mbajtja e kalendarit të vaksinimit lehtësohet dhe bëhet më e qartë. Vaksinat polivalente të lejuara në Gjermani janë po aq të sigurta dhe të efektshme sa edhe vaksinat e veçanta.

**Tetanos** është një sëmundje infektive me rrezik për jetën. Bakteri që gjendet kryesisht në tokë dhe në pluhurin e rrugës depërton në lëkurë përmes plagëve të prerjes, kafshimit, gërvishtjes apo edhe plagëve shumë të vogla, shumohet në trup dhe krijon toksinën infektuese të sëmundjes së tetanosit. Ngërçet e muskujve identifikojnë gjendjen e rëndë shëndetësore dhe kur përfshijnë muskulaturën e frymëmarrjes mund të rezultojnë në mbytje (bllokim i frymëmarrjes). Pavarësisht metodave moderne të trajtimit, ende vdesin më shumë se 10 deri 20 për qind e të sëmurëve me tetanos.

**Difteria** është një sëmundje infektive kërcënuese për jetën që shkaktohet nga helmi (toksina) e bakterit të difterisë, që transmetohet kryesisht nga infeksionet në stërkalat që qarkullojnë në ajër. Para se të futej vaksinimi, shumë fëmijë vdisnin nga infeksioni i shkaktuar nga difteria e grykëve, laringjtit, hundës dhe plagëve ose vuanin nga dëmtimi i muskulit të zemrës. Vaksinimi në shkallë të gjerë e ka eliminuar difterinë në Gjermani, përveç ndonjë rasti të veçantë. Duke qenë se ajo shfaqet kudo - edhe në disa vende të Evropës Lindore - ekziston gjithnjë rreziku i futjes dhe infektimit gjatë udhëtimeve.

**Kolla e mirë** (pertusis) në të shumtën e rasteve fillon si ftohje. Më vonë shfaqen kollitje të rënuara dhe shpesh ndodhin edhe vështirësi në frymëmarrje dhe të vjella. Në 6 muajt e parë të jetës kolla tipike mund të largohet, por ekziston rreziku i problemit në frymëmarrje; prandaj infeksioni në vitin e parë të jetës është tepër kërcënues. Përqindja e komplikimeve serioze në moshën e fëmijërisë është e lartë, ku mund të shfaqen veçanërisht pneumonia, inflamacioni i veshit të mesëm dhe dëmtimet e përhershme të trurit.

Sëmundjet e shkaktuara nga bakteri **Haemophilus influenzae tipi b** (Hib) i përkasin sëmundjeve infektive më të rënda në fëmijëri. Sëmundje frikësuese janë meningjiti dhe rastet e mbytjes që lidhen me inflamacionin e mukozës së epiglotit dhe laringut. Në të shumtën e rasteve këto sëmundje shfaqen duke filluar nga muaji i 5-të deri në vitin e 3-të të jetës; pas moshës 5-vjeçare këto sëmundje shfaqen shumë rrallë.

**Poliomieliti** është një sëmundje virale, e cila çon në paralizimin e krahëve dhe këmbëve, por mund të pengojë edhe frymëmarrjen dhe të rezultojë në mbytje. Shumicës së të sëmurëve me paraliza u mbeten dëmtimet. Që nga viti 1998 vaksinimi kundër poliomielitit nuk bëhet më nga goja, por me një vaksinë me injeksion të përbërë nga viruse të ngordhura të polios (vaksinë inaktive). Poliomieliti nuk ndodh më në Evropë. Por ka rrezik infektimi përmes

sëmundjeve të marra dhe nga udhëtimet në vende me poliomielit, veçanërisht në Azi dhe Afrikë. Vaksinimet kundër poliomielitit duhet të bëhen edhe sot në mënyrë konsekuente.

**Hepatiti B** është një inflamacion i mëlçisë i shkaktuar nga virusi. Mund të fillojë me simptoma të ngjashme me gripin, të përziera ose dhembje kyçesh dhe më vonë të çojë në verdhëz. Infektimi mund të vazhdojë edhe pa u ndier. Rreth 1% e të prekurve vdesin. Te deri në 10% e të rriturve infektimi bëhet kronik, virusi mbetet në trup dhe mund të çojë në dëmtime të rënda të mëlçisë (cirrozë, kancer). Te fëmijët e vegjël ose te foshnjat, të cilët janë infektuar nga nëna ose ndonjë person tjetër i afërm, ecuria në mënyrë kronike ndodh më shpesh (rreth 30 deri në 90%). Në Gjermani, rreth 0,5% e popullsisë janë të infektuar kronikë me virusin e hepatitit B. Transmetohet përmes gjakut ose të lëngjeve të trupit me personat e infektuar, d.m.th. edhe me anë të marrëdhënies seksuale.

### Vaksina

Vaksina 6-she përmban këta përbërës kryesorë: toksina të detoksikuara të shkaktarëve të difterisë dhe tetanosit, pjesë të bakterit të kollës së mirë (vaksinë joqelizore pertusi) dhe pjesë të membranës së bakterit *Haemophilus-influenzae* të tipit B (vaksinë Hib-konjugat); viruse polio të vdekura; pjesë të membranës së virusit të hepatitit B, të cilat janë përfutur me ndihmën e proceseve të teknologjisë gjenetike duke përdorur qelizat fermentuese. Vaksina bëhet në muskul (injektim ndërmuskulor). Për sa i përket fillimit dhe kohëzgjatjes së vaksinimit mund t'ju informojë mjeku.

### Kush duhet të vaksinohet dhe kur?

Në kuadër të kalendarit të vaksinimit, vaksinimi i kombinuar kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve nga virusi *Haemophilus-influenzae* i tipit B, poliomielit dhe hepatit B rekomandohet për gjithë fëmijët që nga java e 8-të. Foshnjat duhen vaksinuar sa më herët, d.m.th. kur bëjnë 2, 3 dhe 4 muaj, i ndjekur më vonë nga një tjetër vaksinim kur mbushin 11 deri në 14 muaj. Të gjitha dozat e përcaktuara të vaksinimit duhen administruar mundësisht në kohën e rekomanduar. Udhëzim: Sipas rekomandimeve të STIKO-s (Komisioni i Përhershëm i Vaksinimit), kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë dhe poliomielitit mbrojtja duhet ripërtëritë në moshën e shkollës dhe më pas.

### Kush nuk duhet vaksinuar?

Kur dikush vuan nga një sëmundje akute në trajtim e sipër dhe me temperaturë (mbi 38,5°C) nuk duhet të vaksinohet. Nëse ka ndonjë hipersensitivitet ndaj një përbërësi të vaksinës ose nëse pas ndonjë vaksinimi të mëparshëm janë shfaqur simptoma sëmundjeje nga një ose disa patogjenë që janë pjesë përbërëse e vaksinës polivalente, mjeku vaksinues i këshillon prindërit për domosdoshmërinë dhe mundësitë e një vaksinimi tjetër. Kjo vlen edhe për fëmijë të sëmurë në mënyrë kronike ose për fëmijë tek të cilët dyshohet për ndonjë sëmundje kronike.

### Reagimi pas vaksinimit

I vaksinuari nuk ka nevojë për ndonjë mbrojtje të veçantë, ngarkesat trupore të pazakonta duhet të largohen brenda 3 ditësh pas vaksinimit. Për fëmijët që mund të kenë probleme me qarkullimin e gjakut ose tek të cilët alergjitë janë të njohura, duhet informuar mjeku përpara vaksinimit.

**Reaksionet e mundshme lokale dhe të përgjithshme pas vaksinimit**

Pas vaksinimit, krahas qëllimit në lidhje me imunitetin dhe mbrojtjen nga sëmundja, shpesh vendi i vaksinimit mund të skuqet ose të ënjtet dhe të ketë dhimbje. Kjo shpreh ndërveprimin normal të trupit me vaksinën dhe shfaqet së shumti për 1 deri në 3 ditë dhe rrallë ndodh që zgjat më shumë. Ka raste kur nyjat limfatike fryhen. Ka raste kur ënjtet e gjithë gjymtyra (këmba ose krahu). Po kështu, nga 1 deri 3 ditë mund të ketë shqetësime të gjendjes së përgjithshme, si rritje e temperaturës, simptoma të ngjashme me gripin, (të dridhura, dhembje koke dhe gjymtyrësh, lodhje) dhe kollë, axhitim, irritim dhe britma të pazakonta. Po ashtu, janë të mundshme mungesë oreksi, të përziera, të vjella ose diarre. Shpesh ndodh edhe temperaturë 39°C e lart. Në përgjithësi, reagimet e përmendura janë kalimtare, ikin shpejt dhe pa pasoja.

**A ndodhin komplikacione nga vaksinimi?**

Komplikacionet nga vaksinimi që e rëndojnë qartë gjendjen shëndetësore të të vaksinuarit janë tepër të rralla, vetëm kur pasojat nga vaksinimi janë mbi masën normale të reagimit ndaj vaksinës. Në raste të veçanta, pas vaksinës 6-she, fëmija i vaksinuar mund të ketë temperaturë të lartë, e cila në përgjithësi bie pa pasur pasojë. Mund të ndodhin edhe reaksione alergjike nga vakcina. Pas vaksinimit me këtë vaksinë polivalente, vetëm në raste të rralla vërehen gjendje të shkurtra shoku, pa reagime dhe me muskulaturë të mpirë, por që rikuperohen shpejt dhe pa asnjë pasojë.

**Këshillimi nga mjeku vaksinues për efektet e mundshme anësore**

Krahas kësaj fletëpalosjeje, mjeku ju ofron një takim për t'ju informuar.

Nëse pas një vaksinimi shfaqen simptoma që i tejkalojnë reagimet kalimtare lokale apo të përgjithshme të përmendura më lart, në dispozicionin tuaj do të jetë gjithashtu për konsultim edhe mjeku vaksinues.

Mjekun e vaksinimit mund ta kontaktoni në:

**Mospranim (mohim)**

Përkthimi i fletës origjinale të Informimit (gjendja e botimit: 11/2014) me miratim të Kryqit të Gjelbërt Gjerman (Deutsches Grünes Kreuz e.V), dhe me autorizim të Institutit Robert Koch. Relevante është teksti gjerman, për ndonjë gabim të përkthimit nuk mund të mbahen përgjegjësi, po ashtu as për aktualitetin e përkthimit në fjalë, në rast të rishikimeve të mëvonshme të versionit original gjerman.

Emri Name \_\_\_\_\_

**Vaksinim kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve nga Haemophilus-infl., tipi B (Hib), poliomielitit dhe hepatitit B**

*Schutzimpfung gegen Wundstarrkrampf, Diphtherie, Keuchhusten, Haemophilus-infl.-Typ-b-Erkrankungen (Hib), Kinderlähmung und Hepatitis B*

Bashkëngjitur keni një fletëpalosje për kryerjen e vaksinimit kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve Hib, poliomielitit, dhe hepatitit B. Kjo përmban të dhënat themelore për sëmundjet që shmang vaksinimi, për vaksinën, vaksinimin dhe për reaksionet e vaksinimit dhe komplikacionet e mundshme të tij.

*Anliegend erhalten Sie ein Merkblatt über die Durchführung der Schutzimpfung gegen Wundstarrkrampf, Diphtherie, Keuchhusten, Hib-Erkrankungen, Kinderlähmung und Hepatitis B. Darin sind die wesentlichen Angaben über die durch die Impfung vermeidbaren Krankheiten, den Impfstoff, die Impfung sowie über Impfreaktionen und mögliche Impfkomplicationen enthalten.*

Para vaksinimit lutemi të jepni edhe të dhënat e mëposhtme:

*Vor Durchführung der Impfung wird zusätzlich um folgende Angaben gebeten:*

1. A gëzon aktualisht i vaksinuari shëndet të plotë?

*Ist der Impfling gegenwärtig gesund?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

2. A ka kaluar i vaksinuari ndonjë sëmundje të sistemit nervor apo ka ndonjë konvulsion?

*Hat der Impfling eine Erkrankung des Nervensystems durchgemacht oder besteht ein Krampfleiden?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

3. A ka i vaksinuari ndonjë alergji të njohur?

*Ist bei dem Impfling eine Allergie bekannt?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

Nëse po, cilën *wenn ja, welche?* \_\_\_\_\_

4. A janë shfaqur tek i vaksinuari alergji, temperaturë e lartë ose reaksione të tjera të pazakonta pas ndonjë vaksinimi të mëparshëm?

*Traten bei dem Impfling nach einer früheren Impfung allergische Erscheinungen, hohes Fieber oder andere ungewöhnliche Reaktionen auf?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

Nëse doni të informoheni më shumë mbi vaksinimin kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve Hib, poliomielitit dhe hepatitit B, pyesni mjekun vaksinues!

*Falls Sie noch mehr über die Schutzimpfung gegen Wundstarrkrampf, Diphtherie, Keuchhusten, Hib-Erkrankungen, Kinderlähmung und Hepatitis B wissen wollen, fragen Sie den Impfarzt!*

Ju lutemi të merrni me vete librezën e vaksinave në takimin për vaksinimin!

*Zum Impftermin bringen Sie bitte das Impfbuch mit!*

**Deklaratë pëlqimi***Einverständniserklärung***për kryerjen e vaksinimit kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve Hib, poliomielitit dhe hepatitit B***zur Durchführung der Schutzimpfung gegen Wundstarrkrampf, Diphtherie, Keuchhusten, Hib-Erkrankungen, Kinderlähmung und Hepatitis B*

(Ekzistojnë edhe formularë me një letër karboni, për t'u dhënë të vaksinuarve ose kujdestarëve të tyre një kopje të dokumentit, sipas ligjit për të drejtat e pacientëve.)

*(Es stehen auch Formulare mit Durchschlag zur Verfügung, um den Impfungen bzw. ihren Sorgeberechtigten gemäß Patientenrechtgesetz eine Kopie mitgeben zu können.)*

Emri i të vaksinuarit \_\_\_\_\_  
*Name des Impflings*

lindur më \_\_\_\_\_  
*geb. am*

Jam informuar mbi përmbajtjen e fletëpalosjes dhe mjeku/mjekja më kanë sqaruar me hollësi për vaksinimin.

*Ich habe den Inhalt des Merkblatts zur Kenntnis genommen und bin von meinem Arzt/meiner Ärztin im Gespräch ausführlich über die Impfung aufgeklärt worden.*

Nuk kam pyetje të tjera.

*Ich habe keine weiteren Fragen.*

Jam dakord për kryerjen e vaksinimit të sugjeruar kundër tetanosit, difterisë, kollës së mirë, sëmundjeve haemophilus influenzae të tipit B, poliomielitit dhe hepatitit B.

*Ich willige in die vorgeschlagene Impfung gegen Wundstarrkrampf, Diphtherie, Keuchhusten, Haemophilus-influenzae-Typ-b-Erkrankungen, Kinderlähmung und Hepatitis B ein.*

E refuzoj vaksinimin. U informova për pasojat e mundshme që sjell refuzimi i vaksinimit.

*Ich lehne die Impfung ab. Über mögliche Nachteile der Ablehnung dieser Impfung wurde ich informiert.*

Shënime: *Vermerke* \_\_\_\_\_

Vendi, Data: *Ort, Datum* \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Firma e të vaksinuarit ose  
kujdestarit

*Unterschrift des Impflings bzw. des Sorgeberechtigten*

\_\_\_\_\_  
Firma e mjekut/mjekes

*Unterschrift des Arztes/der Ärztin*